

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS-kolegji i përbërë nga gjyqtarët:Erdoğan Haxhibeqiri, kryetar, Gyltene Sylejmani dhe Jelena Krivokapiq,anëtarë,në çështjen juridike të paditësit I. Q.,nga ..., të cilin me autorizim e përfaqëson M. (K) B.,avokat nga ...,kundër të paditurës KS''E.'',me seli në Prishtinë, për shkak të shpërblimit të dëmit material dhe jo material,duke vendosur përkitazi me revizionin e të paditurës të paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës në Prishtinë Ac.nr.5551/17 të datës 20.12.2018, në seancën e kolegjit të mbajtur me datën14.05.2019, merr këtë:

A K T G J Y K I M

Refuzohet si i pabazuar revizioni i të paditurës i paraqitur kundër aktgjykimi të Gjykatës së Apelit të Kosovës në Prishtinë Ac.nr.5551/17 të datës 20.12.2018

A r s y e t i m i

Me aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Ferizaj-Dega në Kaçanik C.nr.238/16 të datës 10.10.2017, pjesërisht është aprovuar kërkesëpadia e paditësit dhe është obliguar e paditura që Paditësit I. Q. në emër të shpërblimit të dëmit jo material t'i paguaj dhe atë: për dhimbje fizike shumën prej ,500 €,për frikë të pësuar shumën prej 1,200 €, në emër të dëmit material dhe atë: në emër të ndihmës dhe kujdesit të huaj shumën prej 100 €,në emër të ushqimit ë përforcuar shumën prej 100 €, në emër të rehabilitimit klimatik shumën prej 70 €, si dhe dëmin material në emër të dëmtimit të automjetit në shumën prej 964 €, të gjitha këto me kamatë vjetore prej 8 % duke llogaritur nga data 10.10.2017 e gjerë në pagesën definitive

Detyrohet e paditura që paditësit në emër të shpenzimeve procedurale t'ia paguaj shumën prej 1034 € të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga dita e marrjes së këtij aktgjykimi me kërcënim të përmbarimit me dhunë.

Mbi pjesën e aprovuar të kërkesëpadia paditësve është refuzuar si e pabazuar.

Duke vendosur sipas ankesës së paditurës, Gjykata e Apelit të Kosovës në Prishtinë me aktgjykimin e saj Ac.nr.5551/17 të datës 20.12.2018 ,ka refuzuar ankesën e të paditurës si të pabazuar dhe ka vërtetuar aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë .

Kundër aktgjykimin të gjykatës së shkallës së dytë, në afat ligjor, e paditura ka paraqitur revizion për shkak të shkeljeve thelbësore të dispozitave të Ligjit të procedurës kontestimore dhe aplikimit të gabuar të drejtës materiale, me propozim që të dy aktgjykimet të prishen dhe lënda t'i kthehet gjykatës së shkallës së parë në rigjykim.

Nuk ka pasur përgjigje në revizion të paditurës.

Gjykata Supreme e Kosovës, shqyrtoi aktgjykimin e goditur me revizion, në kuptim të nenit 215 të Ligjit mbi Procedurën Kontestimore (LPK), dhe gjeti se:

Revizioni është i pabazuar.

Në procedura të zhvilluara nuk ka shkelje thelbësore të dispozitave të LPK-së, në të cilat kjo gjykatë kujdeset sipas detyrës zyrtare.

Në bazë të gjendjes së vërtetuar faktike, del se me datën 15.08.2016, në aksidentin e komunikacionit paditësit kanë pësuar lëndime të lehta trupore, dhe se aksidentin ka shkaktuar vozitësi i automjetit me targat e regjistrimit ... ,dhe se automjeti në fjalë ka qenë i siguruar te e paditura. Vozitësi i automjetit ‘VW Golf Fi. B., është shpallur përgjegjës në bazë të aktvendimit të Gjykatës Themelore në Ferizaj –Dega në Kaçanik ,Divizioni Kundërvajtjes R.I nr3470/16 të datës 28.06.2017 dhe është shqiptuar dënimi me gjobë prej 70 €, ndërsa paditësi si i dëmtuar është udhëzuar në kontest civil të realizoj kërkesën pronësore juridike .

Paditësit në këtë aksident kanë pësuar lëndime lehta trupore trupore .Sipas raporteve të ekspertëve Dr.Xh, S, ortoped-traumatolog dhe Dr N, M, -P., kanë konstatuar se paditësi I, Q, , ka pasuar lëndime të lehta trupore . Paditësi në fjalë ka pësuar dhimbjet fizike të intensitetit posaçërisht të rëndë kanë zgjatur 10 minuta, dhimbjet fizike të intensitetit të rëndë kanë zgjatur 12 orë, dhimbje fizike të intensitetit të mesëm kanë zgjatur 7 ditë , dhimbje fizike të intensitetit të ulët ka në vazhdimësi , ka pësuar frikë primare që ka zgjatur disa sekonda ,frika sekondare intensitetit të lartë 24 orë , intensitet të ultë ka zgjatur 1 muaj ,shëmtimi trupor nuk ka, nuk ka zvogëlimi i aktivitetit të përgjithshëm ,përkujdesja e personit të tretë është e nevojshme 7 ditë ,ushqimi i përforcuar ka pasur nevojë 15 ditë si dhe rehabilitimi klimatik ka qenë i nevojshëm 7 ditë .

Gjykata e shkallës së parë në bazë të gjendjes së vërtetuar faktike ka obliguar të paditurën që paditësit në emër të dëmit jo material dhe material të paguajë shumat e përcaktuara si në dispozitiv të aktgjykimit të saj.

Gjykata e shkallës së dytë në procedurë ankimore ka refuzuar ankesën e të paditurës ka vërtetuar aktgjykimin e gjykatës së shkallës së .

Duke u nisur nga kjo gjendje e vërtetuar faktike gjykatat e shkallës së dytë në mënyrë të drejtë ka aplikuar dispozitat materiale kur me aktgjykimin e sulmuar ka refuzuar ankesën e të paditurës dhe ka vërtetuar aktgjykimin e shkallës së parë.

Gjykata e shkallës së parë ka arsyetuar vendimin e saj për pranimin e shumave të gjykuara duke marr parasysh natyrën e lëndimeve, intensitetit dhe kohë zgjatjës së të dhimbjeve fizike dhe të frikës , kohëzgjatjen dhe nevojën për ushqim të përforcuar dhe kujdes të huaj ,si dhe nevojën dhe kohëzgjatjen e rehabilitimit fizioterapik –klimatik për paditësin ,prandaj nuk qëndrojnë thëniet e revizionit se gjykatat e instancës më të ulët nuk kanë marr parasysh me rastin e caktimit të shumave në emër të dëmit material dhe jo material natyrën e lëndimeve, intensitetin dhe kohëzgjatjen të dhimbjeve fizike dhe të frikës ,kohëzgjatjen dhe nevojën për ushqim të përforcuar dhe kujdesin e huaj .

Shumat e gjykuara në emër të dëmit jo material janë reale dhe paraqesin satisfaksion të plotë për paditësin në kuptim të nenit 200.par1 të Ligjit për marrëdhëniet e detyrimeve dhe standardin jetësor të qytetarëve të Kosovës si dhe praktikën gjertanishme të gjykatave të Kosovës. Shumat e caktuara janë në përputhje me kriteret e parapara sipas kësaj dispozite ,për të cilën arsye aktgjykimi i shkallës së dytë është vërtetuar.

Nuk qëndrojnë thëniet e revizionit se paditësi nuk ka pasur kontakt me automjetin e siguruarit të paditurës ,nga arsyeja se gjerë te aksidenti ka ardhur ku i siguruari e të paditurës merr veprim ku rrezikon pjesëmarrësit në komunikacion e në rastin konkret paditësin i cili për të shmangur aksidentin del jashtë rruge dhe se veprimi i siguruarit të paditurës është lidhje kauzale me pasojën , gjegjësisht dëmin e shkaktuar të paditësit dhe se për këtë është deklaruar eksperti i Komunikacionit B. L.

Nuk qëndrojnë thëniet e revizionit se paditësi nuk ka pësuar lëndime pasi që për këtë është deklaruar eksperti Dr. Xh. S. .

Nga sa u tha më lart e në bazë të nenit 222 të LPK, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS NË PRISHTINË

Rev.nr.133/2019 datë 14.05.2019

Kryetar i kolegjit,
Erdogan Haxhibeqiri

